



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 17 shkurt 2025, për nder të 17 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Mbledhja filloi në ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në Shtëpinë e Bardhë.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, znj. Antigona Bytyqi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Të dashur qytetarë të Prizrenit, shumë të nderuara familje të dëshmorëve, të nderuar invalidë e veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shumë i nderuar kryetar i komunës zotëri Shaqir Totaj, nënkryetar zotëri Gashi, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të ekzekutivit, të nderuar përfaqësues nga konsulatat Turke, përfaqësues nga FSK, përfaqësues nga policia, nga Kfori Turk, i nderuar kryetari i parë i komunës së Prizrenit profesor Kadri Kryeziu, i nderuar ish-ambasador zotëri Nait Hasani, përfaqësues të QKMF-së, përfaqësues të këndit amerikan, të nderuar përfaqësues të komunitetit fetar, të bizneseve, shoqërisë civile, media, të nderuar të pranishëm, mirë se keni ardhur në seancën solemne të ftuar për nder të 17 shkurtit, ditës së pavarësisë së Kosovës. Kam nderin dhe kënaqësinë që sot të hap këtë seancë solemne në përkujtim të një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë tonë kombëtare, shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. 17 shkurti i 2008 shënoi një epokë të re për vendin tonë, një realizim të aspiratave shekullore të popullit të Kosovës për liri, demokraci dhe shtet të pavarur. 17 vjet më parë, ëndrra shekullore e Kosovës u bërë realitet. Një ëndërr që u pagua me mund, me sakrificë, me jetë njerëzish të pafajshëm, me lot nënash dhe me guxim të paepur. Sot me përkulje dhe me zemër plot mirënjohje, nderoj ata që me guxim, sakrificë dhe gjak shkruajtën kapitullin më të lavdishëm të historisë sonë, luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kujtojmë me nderim të thellë dëshmorët që dhanë jetën për këtë tokë dhe të gjithë ata që kontribuan për lirinë dhe shtetësinë tonë. Le të festojmë këtë ditë me krenari dhe le të vazhdojmë të punojmë sëbashku për një Kosovë më të fortë, më të zhvilluar, duke ruajtur lirinë dhe duke ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët tanë. Gëzuar përjetësisht pavarësinë e Kosovës, lavdi dëshmorëve, nderim të përjetshëm luftëtarëve të lirisë dhe rroftë Kosova e lirë. Ju faleminderit! Në këtë moment solemni kemi nderin që tani të dëgjojmë përfaqësuesit e subjekteve politike me urimet dhe mesazhet e tyre. E fillojmë me Lëvizjen Vetvendosje.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese, të nderuar dhe shumë të respektuar familje të dëshmorëve, martirëve, invalidë e veteranë të luftës së UÇK-së. Të dashur përfaqësues të

Ushtrisë, të policisë, KFOR-it, krerët fetarë, i nderuari kryetar, koleg kuvendar, shumë të dashur qytetarë të komunës së Prizrenit. Sot në këtë datë të 17 shkurtit jemi mbledhur në këtë seancë solemne të Kuvendit të komunës për nder të 17 vjetorit të republikës sonë. Ky përvjetor, si çdo përvjetor tjetër i kaluar padyshim që na përkujton të gjithëve vlerën e sakrificës, guximit, vetëmohimit, atdhedashurisë e angazhimit të pashoq të shumë gjeneratave për liri dhe pavarësi që sot ne të gjithë së bashku e festojmë në paqe dhe të lirë. Këto vlera madhështore duhet patjetër apo domosdoshmërisht të kultivohen gjeneratë pas gjenerate. Ashtu siç erdhëm deri tek kjo ditë e shpalljes së pavarësisë me shumë mund e punë të pandalshme, gjithsesi duhet që edhe nga pozitrat udhëheqëse e nga çfarëdo lloji pozicioni që secili prej nesh ka në këtë Republikë, duhet t'i lëmë anash të gjitha interesat personale e klanore, që të vazhdojmë me kontributin e secilit nga ne për një shtet-ndërtim dhe forcim të këtij vendi në secilën sferë jetësore. Dhe kjo duhet të bëhet pandërprerë e deri në frymën e fundit. Së fundi, pa e zgjatur shumë nga ky kuvend, shfrytëzoj rastin që në emër të Lëvizjes Vetëvendosje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës t'ua uroj 17 vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit zotri Haxhillari. Vazhdojmë me Partinë Demokratike të Kosovës.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit kryesuese. Të nderuara familje të dëshmorëve, të nderuar invalidë e veteranë të luftës, të nderuar përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës, të nderuar përfaqësues të policisë së Kosovës, i nderuar kryetar i komunës së Prizrenit zotëri Totaj, i nderuar kryetari i parë i komunës së Prizrenit zotëri Kryeziu, i nderuar nënkryetar i komunës së Prizrenit zotëri Gashi, e nderuara kryesuese e kuvendit zonja Bytyqi, të nderuar ekzekutiv, koleg kuvendar, media, shoqëri civile, të nderuar përfaqësues të bizneseve, përfaqësues të bashkësive fetare, të nderuar përfaqësues nga konsolata turke dhe të nderuar të gjithë ju të pranishëm. Jemi mbledhur për të shënuar një nga datat më të rëndësishme në historinë e kombit tonë, 17 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku kjo ditë është simbol i sakrificës, guximit dhe vendosshmërisë së një populli që kurrë nuk u dorëzua përballë padrejtësive dhe sfidave. Pavarësia e Kosovës nuk ishte një dhuratë, por një e arritur e fituar me gjakun e dëshmorëve, me sakrificën e familjeve të tyre, me mundin e invalidëve të luftës dhe me përkushtimin e mijëra luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku ishte një rrugë e vështirë, një rrugë e mbushur me sakrifica dhe dhembje, por edhe me shpresë dhe besim për të ardhmen. Në vitet e errëta të okupimit ku padrejtësia dhe shtypja ishin bërë realitet i përditshëm, djemtë dhe vajzat më të mira të kombit tonë u ngritën për të mbrojtur vlerat e lirisë dhe dinjitetit njerëzor, nën udhëheqjen e figurave të shquara si Adem Jashari, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe shumë të tjerë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi si një shpresë dhe forcë e pa thyeshme për popullin tonë. Më 17 shkurt 2008 ëndrra e brezave të tërë u bë realitet, ku në kuvendin e Kosovës përfaqësuesit e popullit tonë miratuan deklaratën e pavarësisë duke shpallur Kosovën një shtet të lire, demokratik dhe sovran, ku kjo ditë nuk ishte thjesht një shpallje formale, por një kurorëzim i sakrificës dhe përkushtimit të të gjithë atyre që e dashën Kosovën të lirë. Të dashur qytetarë të Kosovës, sot është një ditë feste, por nuk është festë e plotë sepse Kosovës i mungojnë çlirimtarët, si Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi e bashkëluftëtarë të tjerë që sot janë larg nesh duke zhvilluar betejën e fundit për të vërtetën e luftës tonë për liri, ku në fakt duhet të ishim këtu në Kosovën e lire, duke e festuar këtë datë madhështore protagonistë të së cilës ishin vetë ata e ndonëse ata nuk janë sot me

neve fizikisht, por janë gjithmonë në zemrat e qytetarëve të Kosovës dhe duke besuar fuqishëm në drejtësi, nuk kemi as mëdyshjen më të vogël se shumë shpejt do të kthehen në Kosovë si fitimtar. Prandaj le të festojmë këtë përvjetor me krenari, por edhe me përgjegjësi për të ardhmen e Kosovës, sepse liria dhe pavarësia janë arritur me shumë mund dhe gjak, ndaj mbetet në dorën tonë t'i mbrojmë dhe t'i forcojmë ato. Lavdi dëshmorëve dhe të rënëve për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë, gëzuar 17 vjetorin e pavarësisë së Kosovës, rrëf Kosova e lirë dhe e pavarur.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit zonja Hoxha, përfaqësuesi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesuese, të nderuar qytetarë të Prizrenit, të nderuar kryetar Totaj, kryesuese e kuvendit, ju anëtarë të kuvendit, të nderuar përfaqësues të forcës së Sigurisë, Policisë së Kosovës, përfaqësues të shoqatave të dalë nga lufta, të komunitetit fetar, të shoqërisë civile, të medias, të nderuar ish-kryetar i komunës zoti Kryeziu, ambasador Nait Hasani, zonja dhe zotëri. Me nder dhe krenari të veçantë ju drejtohem sot për të shprehur urimet më të përzemërta për një ditë më të rëndësishme të historisë tonë kombëtare, 17 shkurtin, ditën kur Kosova shpalli pavarësinë e saj dhe hapi një kapitull të ri si shtet i lirë, i pavarur dhe sovran. Kjo ditë nuk është thjesht një datë në kalendar, por është një përkujtim i përpjekjeve tona të gjata, të mundimshme të gjeneratave që u flijuan për lirinë, pavarësinë dhe të ardhmen e këtij vendi. Vizioni politik e diplomatik i Atit themelues të Kosovës shtet presidentit historik zotit Ibrahim Rugova, sakrificat e komandantit legjendar Adem Jashari me familje, sakrificat e brezave nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri të mbështetja e miqve tanë ndërkombëtarë, janë këto që çdo hap na solli deri këtu. Si përfaqësues të qytetarëve në këtë kuvend kemi përgjegjësinë që amanetin e dëshmorëve dhe sakrificën e popullit ta nderojmë duke punuar për zhvillimin e komunës sonë, për mirqënien e qytetarëve dhe forcimin e institucioneve demokratike. Pavarësia nuk është vetëm një fitore e së kaluarës, por është edhe një përgjegjësi e madhe për të ardhmen. Në këtë ditë të shënuar, do të zotohemi se do të vazhdojmë të punojmë për një Kosovë më të zhvilluar, më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Do të kujtojmë me respekt të gjithë ata që kontribuan për këtë ditë dhe të angazhohemi për një të ardhme më të mirë dhe të ndritur. Gëzuar 17 shkurtin, gëzuar pavarësinë e Kosovës, ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit dhe zotëri Hodaj, përfaqësuesi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, të nderuara familjet e dëshmorë, veteran, invalid të luftës, i nderuar zotëri Kryeziu, zotëri Hasani, Polici e Kosovës, Ushtrinë, përfaqësues të Kforit, i nderuar kryetar, kabinet qeveritar, shumë të respektuar mysafir, të nderuar kolegë. Sot e 17 vite mëparë ishte një ditë e jashtëzakonshme, emocionuese dhe e lavdishme për Kosovën dhe popullin shqiptar. Ditë kjo e shumë kërkuar dhe e shumë pritur, e fituar me sakrificë, me vuajtje dhe mund të paraprirë me luftë deri në çlirimin e vendit. Shpallja e pavarësisë më 17 shkurt e vitit 2008 ishte momenti që secili që frymonte shqip, kulmonte me ndjenjat më të larta të kënaqësisë dhe krenarisë shqiptare. Vuajtja shekullore e popullit nga barbaria asaj kohe detyruan organizimin e grave dhe burrave më të veçantë që të kundërvihen në formë të ndryshme okupatuarit deri në luftën çlirimtare që do sillte lirinë e plotë të vendit. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në bashkëpunim dhe bashkërendim me shtetet aleatë e botës, gjaku i derdhur i dëshmorëve dhe

martirove tanë na sollën të shtrenjtë në liri. Spektri I bashkuar politikë dhe jo vetëm kontribuan në shtetndërtim deri në shpallje të pavarësisë. Shteti u bë u njoh nga bota. Shteti u ndërtua në të gjitha sferet shtetërore, administratë, arsim, polici, ushtri, infrastrukturë rrugore, shumë çka tjetër me një progres jo të zakonshëm, duke marrur parasysh sfidat politike, ekonomike dhe shoqërore. Por tani kemi obligime më shumë se asnjëherë dhe askush tjetër që shteti ta ruajmë dhe ta kultivojmë me zhvillim ekonomik, mirëqenie, kulturë dhe arsimim, bashkim dhe jo polarizim të panevojshëm, apo për qëllime krejtësisht të tjera dhe jo ato shtetërore dhe shoqërore. Koha është e interesit të Kosovës të jemi të bashkuar dhe të forcojmë lidhjet tona dashamirëse për këtë vend të bekuar. Ta forcojmë shtetin tonë të fituar me gjak dhe mund për nder të atyre që dhanë gjithçka dhe për të ardhmen e atyre që u kemi obligim. Lavdi dëshmorëve, urime dita e pavarësisë gjithëve. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit dhe zoti Kastrati. Vazhdojmë me përfaqësuesen nga Nisma.

Shukrije Berisha (Nisma): Faleminderit kryesuese. Të nderuar ju familje të dëshmorëve, martirëve, veteranë e invalidë të luftës. I nderuar lider i komunës së Prizrenit Shaqir Totaj. E nderuara kryesuese, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtor, koleg kuvendar, ju qytetar të Prizrenit, përfaqësues të institucioneve dhe ju të ftuar e të nderuar. Sot qëndroj para jush me krenari dhe përgjegjësi për të shënuar një moment historik, 17-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Andaj, në emër të Nismës socialdemokrate, dëshiroj t'ju përcjell juve dhe çdo qytetari të Kosovës, urimet më të përzemërta me rastin e 17 vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Kjo ditë është fryt i guximit të popullit tonë, i luftës së lavdishme të UÇK-së, është një ditë e shenjtë për kombin tonë. Një ditë kur kujtojmë sakrificën, guximin dhe përkushtimin e mijëra burrave dhe grave që dhanë gjithçka për lirinë dhe shtetin tonë të pavarur. Sot kujtojmë me respekt të thellë herojtë tanë, dëshmorët e kombit, luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjithë ata që kontribuan për këtë ditë historike. Për sakrificën e tyre dhe mbështetjen e aleatëve tanë, ne nuk do të kishim mundur të gëzonim këtë ditë si një shtet i lirë dhe sovran. Pavarësia e Kosovës, nuk është vetëm një akt juridik i shpallur më 17 shkurt të vitit 2008. Ajo është një ideal i ndërtuar mbi bindjen, përpjekjet dhe emrat e brezave të tërë, andaj Kosova jonë është amaneti i gjakut të derdhur dhe ne duhet të ndërtojmë atë me punë dhe përkushtim. Urime e gëzuar dita e pavarësisë të gjithë qytetarëve të Kosovës. Urime.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit zonja Berisha, vazhdojmë me përfaqësimin nga Yhtp.

Sevil Kazaz (Ythp): 19:15- 21:00

Sead Arifi (Vakat): 21:20 – 22:45

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Tani e ftojme edhe kryetarin e komunës zotërin Shaqir Totaj që ta merr një fjalë rasti.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Më së pari du me i përshëndet familjet e dëshmorëve, të gjitha kategoritë e shoqatave të dala nga lufta, me i përshëndet përfaqësuesit e policisë, përfaqësuesit e ushtrisë, përfaqësuesit e KFOR-it turk, mikun tonë konzulli i Republikës Turke po ashtu me

përshëndet përfaqësuesit e bashkive fetare edhe mediat edhe mysafirët në qoftë se kemi këtu natyrisht Naitin edhe profën Kadrin si kryetar i parë i komunës së Prizrenit si dhe kolegët e mi të qeverisjes lokale nënkryetarin Kujtimin, Antigonen edhe drejtorat që e kemi këtu mbrapa. Ishalla se kam harruar ndonjë kënd se zakonisht i harroj tani. Asambleistët. Juve po ju llogaris si pjesë e familjes. Është një ditë shumë e rëndësishme në historinë më të re të kombit shqiptar, veç ata që janë qenë që kanë jetuar në një shtet që kanë qenë të diskriminuar vazhdimisht, e dinë çka do me thënë, liria dhe pavarësia. Ne të gjithë e dimë qysh e kemi përjetuar ditën kur ka përfunduar lufta, edhe kur e kemi ditur që definitiv që është liruar. Dikush është qenë këtu, dikush jo, por është një ndjenjë e papërshkrueshme. Kështu që jemi falenderues ndaj të gjithë atyre të cilët në një mënyrë ose tjetër kanë kontribuar që të vjen kjo ditë. Normal 17 shkurti është ditë e veçantë, prandaj unë e shfrytëzoj rastin që t'ja uroj të gjithëve, jo vetëm shqiptarëve, por të gjithëve që jetojnë në Kosovë edhe në Prizren, t'ja uroj ditën e pavarësisë sepse është ditë e veçantë edhe shënon një momentum të ri, një etapë të re në historinë tonë shtetërore, po edhe kombëtare. Është shumë e rëndësishme që të dimë të çmojmë këtë liri, të dimë të vlerësojmë kontributin e të gjithë atyre personave, jo veç atyre që kanë vdekur, po edhe atyre që janë gjallë, edhe t'i respektojmë sakrificën sepse pa sakrificën e tyre nuk kishin ardhë deri te kjo ditë këtu. Nuk po duhet me u kthyer shumë mbrapa, veç për të me u kthyer në historinë më të re, në momentin kur në ish-Jugosllavi është formuar në sistemi shumë partiak, edhe njëherë me specifikuar rolin historik të presidentit Ibrahim Rugova, i cili me një qetësi edhe mençuri e ka ngritur Kosovën në axhenda ndërkombëtare shumë nalt. Më vonë kanë ardhur dhe etapa të tjera, se u pa se pa luftë nuk do të mundeni. Prandaj të gjithë ata, secili në mënyrën e vetë dhe në fazën e vetë e ka dhënë kontributin e vetë, në mënyrë që ne sot të jemi këtu ku jemi. Duhet edhe jemi mirënjohës ndaj të gjithë atyre që na kanë ndihmuar. Mos harrojmë që pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar, aleatëve tonë nuk do të kishin mund me shpallur as pavarësinë, as me u shliuar, prandaj duhet të jemi mirënjohës dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm në mënyrën se qysh komunikojmë me ata. Lirinë e kemi, shtetin e kemi, pavarësinë e kemi, është obligim i yni që të vazhdojmë mëtej me ndërtimin e këtij vendi, të vazhdojmë mëtej me promovimin e këtij vendi. Ka pasur zhvillime shumë pozitive. Ka pasur ndërtim të strukturës administrative, ndërtim të institucioneve, ndërtim të infrastrukturës. Dimë t'i çmojmë këto, dimë t'i respektojmë këto. Dimë t'i vlerësojmë ata njerëz të cilët e kanë dhënë kontributin e vet, secili në mënyrën e vetë edhe në fazën e vetë. Të jemi mirënjohës sepse nuk është në natyrën tonë as individuale, as kombëtare, mos me qenë mirënjohës ndaj atyre të cilët kanë kontribuar dhe të cilët na kanë ndihmuar neve. Si popull jemi mirënjohës, si popull, jemi të tillë që dimë me çmu edhe me vlerësua edhe jo për arsye thuhet trim i mirë me shokë shumë. Po zakonisht kjo në histori ndodh që kur të je në rrugë drejtë edhe aleatë të bashkohen. Prandaj edhe kemi pas miq edhe kemi pas aleatë. Prizreni është një shembull shumë i mirë se qysh me një punë, me një tolerancë, me një bashkëjetesë mundet me u ndërtu një kulturë qytetare, mundet me u ndërtu një shembull se qysh duhet me funksionuar ndoshta krejt pjesa tjetër e Kosovës, e këtu secili prej neve e ka dhënë kontributin e vetë. Uroj që edhe në të ardhmen të vazhdojmë në këtë mënyrë, t'i ruajmë dallimet tona që kemi në mesvetsi sepse ato janë pjesë e mënyrës demokratike të jetës. Dallimet që kemi në mesvete na bëjnë më të fortë, na bëjnë më komplet. Prandaj të vazhdojmë me përkushtim të ndërtojmë ato që brezat përpara neve e kanë filluar, kemi potencial, kemi resurse, kemi energji, na vynë pak një matuni, një pjekuni edhe jam shumë i sigurtë që do të lëvizim së bashku në rrugën e drejtë. Prandaj edhe një herë të gjithëve ju uroj ditën e pavarësisë, edhe meqënëse isha në këto

lutjet e mëngjesit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atje shumë shpesh e përdornim Zoti e bekoftë Amerikën, unë po them Zoti e bekoftë Kosovën bashkë me të gjithë neve që jemi këtu. Ju falenderoj për vëmendje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit i nderuar kryetar. Të nderuar mysafirë të pranishëm, duke ju falenderuar të gjithëve për pjesëmarrje, ju ftoj që të gjithë së bashku të shkojmë për homazhe në vendin e dëshmorëve, në varrezat e dëshmorëve. Ju faleminderit dhe shihemi në mbledhjen tjetër.

Mbledhja përfundoi në ora 09:35.



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi